

Sa është shuma e të ardhurave tuaja familjare?

Janar Shkurt Mars etj.

Shuma e të ardhurave



Mbani mend:

KREDITË NUK JANË TË ARDHURA!

Mos e shkruani ende vlerën e kredisë - për ato do të flasim në hapin e 5-të.



HAPI 3:

Planifikoni shpenzimet tuaja për periudhën e njëjtë. Shkruani numra të përafërt në bazë të përvojës së mëparshme. SHKRUANI PAGESAT E KREDIVE SI SHPENZIME PËR ÇDO MUAJ!

Llogaritni shumën mujore për këto lloje të shpenzimeve:
Janar Shkurt Mars etj.

ushqim
transport
energji elektrike
qiraja
ujë/gaz
telefon / internet
nevojat e fëmijëve
festa dhe dhurata
të gjitha pagesat për kreditë
pushime
furnizime tjera
të planifikuara
veshmbathja
shpenzime të tjera

Shtoni një shumë të shpenzimeve të cilat nuk mund të parashihen (për raste urgjente dhe shpenzime të papritshme).

Tani llogaritni shumën totale të shpenzimeve dhe furnizimeve:

Janar Shkurt Mars etj.

Shpenzime dhe furnizime



MOS MERRNI KREDI PËR SHPENZIMET E PËRDITSHME! ATË SHFRYTËZONI VETËM PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE FINANCIARE



HAPI 4:

Llogaritni kursimin e pritsëm për çdo muaj, përgjatë gjithë vitit. Nëqoftëse kursimi juaj është në minus në çdo periudhë, mund të keni telashe! Mendoni në lidhje me reduktimin e shpenzimeve ose përpiquni të fitoni më shumë.

BUXHETI FAMILJAR:

Janar Shkurt Mars etj.

Të hyrat totale
Shpenzime dhe furnizime
Kursimi mujor
(të hyrat MINUS shpenzimet)
Kursimi vjetor

HAPI 5:

Krahasoni kursimin tuaj mujor me qëllimet mujore financiare. A keni kursime të mjaftueshme që t'i arrini qëllimet tuaja?
Nëse jo, mund të mendoni për marrjen e kredisë.
Mbani mend: Pagesa juaj mujore për kredi të re duhet të jetë 70-80% më e vogël se kursimi juaj mujor.

Nëse merrni kredi, atëherë mbani mend se duhet të shtoni pagesën mujore të kredisë në buxhetin tuaj të ardhshëm, sepse kthimi i kredisë nënkupton rritje të shpenzimeve dhe zvogëlim të kursimit.



A UDHËHIQNI JU ME PARATË TUAJA APO PARATË UDHËHEQIN ME JU?

"Zgjedhja është e juaja. Të përpiqeni vazhdimisht për të lidhur muajin me muaj ose të menaxhoni paratë tuaja me mençuri, për të nxjerrë maksimumin nga ato që keni".

"Gjithmonë dalin gjëra për të cilat ka nevojë për shpenzime shtesë. Kjo thjesht është e pashmangshme..."



Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Rr. Garibaldi, Nr. 33. Prishtinë. Kosovë.
www.bqk-kos.org

Menaxhimi me para vlen për të gjithë, e jo vetëm për njerëzit me shumë para.

A janë të definuara qëllimet tuaja financiare? Sa para janë të nevojshme për t'i realizuar ëndërrat tuaja? Nëqoftëse përgjigjja juaj është "shumë", me siguri keni aspirata - por a mund t'i shndërroni në "qëllime" konkrete, me shuma dhe afate konkrete?

Çdokush do të duhej të menaxhonte me paratë e tij dhe të gjejë mënyrën për të kursyer më shumë. Nëqoftëse nuk mundeni t'i ndiqni të ardhurat dhe shpenzimet tuaja, jeni të ekspozuar ndaj rrezikut të blerjes së gjësendeve për të cilat ju nuk keni nevojë, ose shpenzimeve të tepërta.

Kursimi nuk ka të bëjë me koprracinë. Ajo është një zgjedhje e mençur.

Nuk më pëlqen të jem koprrac - kursimi nuk është për mua!



A ju duken shumë 10% e të ardhurave tuaja mujore për t'i kursyer? Në fillim kjo shumë mund të ju duket e vogël, por për më shumë se një vit, fitoni 120% ose më shumë se të ardhurat tuaja mujore, vetëm si rezultat i kursimit. A nuk mendoni se ia vlen?



"Menaxhimi i parave!"

"Në fakt është me të vërtetë i lehtë dhe nuk ka asnjë arsye të mos e bëni. Është e rëndësishme që të keni një plan të thjeshtë dhe t'i përmbaheni atij. Disiplina juaj do të paguhet!"



A e dini se...?



Nëpërmjet menaxhimit të duhur dhe monitorimit të asaj që keni shpenzuar, do të kurseni 20% të shpenzimeve tuaja. Si? Duke mësuar se si t'i zbuloni shpenzimet e panevojshme dhe duke sjellë vendime më të mira në lidhje me shpenzimet. Proveni!

Planifikimi është i rëndësishëm. Menaxhimi i financave personale është i rëndësishëm. Ndjekja e shpenzimeve është e rëndësishme. Pak rregull dhe disiplinë, do t'ju ndihmojë që të përmirësoni jetën tuaj.

Filloni ti ndiqni shpenzimet tuaja sot!

Krijoni si shprehje të përditshme t'i rishikoni të ardhurat dhe shpenzimet tuaja dhe t'i analizoni me kujdes, që t'i identifikoni shpenzimet që mund të shmangen. Mësoni t'i vëreni shprehjet tuaja të këqija!

Hapi 1:

Vendosni si familje: çfarë dëshironi të arrini, sa para ju duhen dhe deri kur? Qëllimet mund të jenë për familjen (për shembull për arsimim).

Cili është qëllimi juaj financiar? (shkruani qëllimet tuaja më të rëndësishme)	Për shembull: pagesa e semestrit të parë të shkollimit të vajzës tonë	Qëllimi i fundit 1:	Qëllimi i fundit 2:	Qëllimi i fundit 3:
Kur duhet të arrihet ky qëllim?	25 dhjetor 2020			
Sa para ju duhen deri atëherë?	25 euro			
Sa para që i posedoni do të mund t'i shfrytëzoni për këtë qëllim?	10 euro			
Sa kohë ju duhet që ta kurseni shumën e plotë?	3 muaj			
Kursimet mujore me të cilat do të arrini qëllimin	$(25-10)/3=5$ euro			

Hapi 2:

Analizoni të ardhurat tuaja: shkruani të gjitha burimet e të ardhurave për periudhën e ardhshme. Nëqoftëse nuk keni numra të saktë, mundohuni t'i përafëroni.

Llogaritni shumën totale mujore nga të ardhurat e mëposhtme:

- paga mujore
- pensioni
- fitimi nga shitja e produkteve të caktuara
- të ardhura tjera.